

Arté

REDAKTOR: Shkelzen Maliqi
 E-MAIL: shkelzen.maliqi@gazetaexpress.com
 TEL: 038 76 76 76 FAX: 038 76 76 78

Kosovarët digjitalë

Prezantimi i librit "Digital Natives & Digital Immigrants", i autorit Johann Gunther, i përkthyer në shqip, mbahet sot, me 16 tetor, prej orës 11:00 në Bibliotekën

Kombëtare dhe Universitare. Librin do ta prezantojë Prof. Helmut Karner, i cili ka qenë kryesues i departamentit të arsimit e kërkimeve shkencore në

Nortel të Londrës, i arsimit në Olivetti në Itali, drejtor i përgjithshëm i Olivetti në Vjenë dhe rektor i Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Salzburg.



Express

E enjte

16 tetor, 2008

www.gazetaexpress.com

N° 1307, Viti III, Çmimi: 0.20 € • E përditshme e pavarur kosovare

Teknologjia dhe imigrantët

Në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare u promovua libri "Vendasit digjitalë dhe imigrantët digjitalë" i autorit austriak Johann Gunther.

Johann Gunther
**Vendasit digjitalë
dhe imigrantët digjitalë**

Alfred Beka

alfred.beka@gazetaexpress.com

Prishtinë, 16 tetor – Teknologjitë e reja prahen më mirë në vendet në zhvillim sesa në vendet e zhvilluara. Po ashtu edhe zhvillimi i internetit me kablo të gjera në Kosovë është shumë më i mirë sesa në shumë vende të Bashkimit Evropian. Kjo është vërejtur nga studiuesi austriak, Johann Gunther, i cili në librin e tij të përkthyer edhe në gjuhën shqipe me titull "Vendasit digjitalë dhe imigrantët digjitalë" arrin të sjellë shumë fakte interesante sa i përket zhvillimit të teknologjisë telekomunikative. Në promovimin e këtij libri, që u bë dje në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare, me ç'rast i pranishëm ishte edhe autori, për të folën prof. Helmut Karner dhe përfaqësuesit e kompanisë Konet, e cila është botuese e librit në gjuhën shqipe. Autori i librit, Johann Gunther, u shpreh me këtë rast se ajo që ka paraqitur këtu është e bazuar në fakte dhe në punën që është bërë në laborator. Ai po ashtu shtoi se është përpjekur të mos i ndajë të dy grupet, vendasit dhe imigrantët. "Në shoqëri ato veprojnë bashkërisht dhe e plotësojnë njëri tjetrin. Andaj edhe në librin tim ato

shfaqen bashkë në të gjithë kapitujt. Po ashtu asnjë grupi nuk ua kam përkushtuar asnjë kapitull veçmas", tha Gunther. Duke theksuar se pesëdhjetë përqind e popullsisë kosovare është më e re se njëzet vjeç, Gunther tha se sistemi teknologjik dyklasor këtu ka më pak rëndësi se sa në pjesën tjetër të Evropës. Johann Gunther në këtë libër tregon pikë për pikë përparësitë dhe dobësitë e një zhvillimi teknik që po përparon në mënyrë shumë të shpejt. Ai hulumton gjerësisht ndryshimet shoqërore dhe ngarkesat psikike të njerëzve, por edhe strukturat e pushtetit brenda një bote teknike. Sipas tij, rrjeti social i njeriut të veçantë, përmes mjeteve ndihmëse teknike po e humb rëndësinë; pasoja logjike është vetmimi gjithnjë e më i madh, përkatësisht rritja e të menduarit egoist në njërin anë dhe kontakti me gjithnjë e më shumë njerëz në anën tjetër. Duke folur për këtë libër, prof. Helmut Karner tha se ky nuk është libër për vendasit apo imigrantët digjitalë dhe nuk është libër për teknologjinë. "Ky është më shumë se aq. Ky është një libër shumë gjithëpërfshirës lidhur me ndikimin e teknologjisë në shoqëri. Libri ka 21 kapituj të cilët janë shumë lehtë të lexueshëm dhe të kuptueshëm për aspekte

të ndryshme si politika, etika, përparimi i femrave në fushën e teknologjisë, shoqëria etj.", tha Karner. Ai tregoi se kur e ka lexuar për herë të dytë këtë libër për të përgatitur këtë recension vazhdimisht e ka pyetur vetën se çfarë është më rëndësi për Kosovën ajo që paraqitet në këtë libër. Në fund folën edhe përfaqësuesit e kompanisë telekomunikative "Konet", e cila e ka botuar këtë libër në gjuhën shqipe, të cilët treguan për praninë e kompanisë së tyre në hapësirën kosovare. Prof. Dr. Johann Gunther në pjesën më të madhe të jetës së tij ishte në pozita ndërkombëtare në industrinë e telekomit. Në vitin 1996, si nënkryetar ai ishte pjesëmarrës në ndërtimin e një universiteti të ri austriak për studime post-diplomike: DonauUniversiteti Krems. Pas disa viteve si drejtor i Universitetit të Shkencave Aplikative në St. Pölten, ai erdhi në Prishtinë për ta udhëhequr Agjencinë për Integrim Evropian. Këtë libër ai e ka përfunduar në Finlandë gjatë një qëndrimi për të mbajtur ligjëratë në universitetet në Oulu dhe Raahë. Ndërsa këtë version në shqip e ka adaptuar dhe i ka përpunuar njohurit e tij, të cilat i ka fituar gjatë qëndrimit të tij në Kosovë.

E premtë

17 tetor, 2008

EXPRESS

№ 1307, Viti III, Çmimi: 0.20 € • E përditshme e pavarur kosovare

www.gazetaexpress.com

